

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“KORRIKU 31” SHPK**

Sot me date **11/05/2020** ortaku i vetem i shoqerise si me poshte ;  
**Iredi Xhaferllari**, i datelindjes, 19/09/1988, lindur ne Pogradec dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet kartes se identitetit **I80919085E**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar, themelon shoqerine sa me poshte vijon :

**Kreu I**

**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1.Objekti i shoqerise**

**1.1 Shoqeria ka kete objekt veprimtari :**

Tregtimi me shumice e pakice, import-eksport i mallrave te ndryshme. Import Eksport, shitje me shumice dhe pakice e mjeteve te transportit te kapaciteteve te ndryshme qe sherbejne per transportin e mallrave dhe/ose te pasagjereve. Eksport-import, shitja me shumice dhe pakice e mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire, te kapaciteteve te ndryshme, me ose pa rimorkio, makineri e pajisje industriale. Eksportimport, shitja me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te pjeseve te kembimit,gomave te automjeteve dhe te mjeteve bujqesore, baterive.Hapje dhe shfrytezim i serviseve per riparimin dhe mirembajtjen e te gjitha llojeve te mjeteve. Hapja pika lavazhi. Investime dhe sherbime ne fushen e pasurive te paluajtshme, duke perfshire pa u kufizuar, shitje, qiradhenie, riparime, blerje, rimarrje te pasurive te patundshme ne shqiperi. Kontrolli teknik dhe periodik i automjeteve te kapaciteteve te ndryshme qe perdoren per transportin e pasagjereve ose te mallrave,te mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire. Shitja me pakice e lendeve djegese (nafte,benzine,lubrifikante,etj). Administrimi i 2 pikave te karburantit per shitje me pakice ne territorin shqiptar.Transporti i lendeve djegese brenda dhe jashte vendit me mjetet e shoqerise ose te treteve.Hapja administrimi i pikave te karburantit dhe te mini-dyqaneve per tregtimin e aksesoreve te te gjitha llojeve te automjeteve. Aktivitet ne fushen e turizmit, hotelerise, bar, restorant, intemet-kafe. Import-eksport i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore dhe perdorim shtepiak si: detergjente, tregtim i te gjitha materialeve, veshmbathje, tuba rekordi, elektropompa dhe mirembajtja e tyre, etj me shumice dhe pakice,te artikujve kancelarie te te gjitha llojeve, pajisje kompjuterike te te gjitha llojeve. Tregtim pajisje elektrike dhe elektronike si dhe sherbimin per to, prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit, ndertimin e objekteve me karakter social e publik, investime ne fushen e ndertimit etj. Zbatime punimesh ndertimi, konsulence, supervision dhe kolaudim punimesh. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha produkteve bujqesore, punime te ndryshme ne bujqesi (mbjellje , korrje , shirje etj), transport i produkteve bujqesore. Shpime me sonde, import-eksport, makineri e pajisje transporti , pjese kembimi per makineri dhe pajisje te ndryshme, mallra dhe pajisje elektrike, elektroshtepiake te te gjitha llojeve, tregti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial etj,



**Internet cafe, Bar - Restorant, Hoteleri Turizem etj. Ne fushen e prodhimeve te ndertimit: Prodhim dhe tregtime te materialeve, prodhim dhe tregtimi i betoneve te ndryshme , parafabrikate dhe elemente te ndertimit, prodhimin e elementeve gjysem fabrikat, prodhim dhe tregtim i dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini, te drejten e franksionimeve te zhavorreve etj, Veprimtari me fushen e ndertimit si ndertime civile, ndertime industrial, turistike, bujqesore etj. Veprimtari ne fushen e turizmit, transportit, industrise, ne perpunimin e tregtimin e lendeve djegese etj. Shoqeria, brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Shoqeria mund te hape veprimtari te reja, te krijojë siper marrje te reja ose te marre pjese ne siper marrje te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit pa cenuar objektin kryesore te shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Shit-blerje bileta avioni, 3 mbushje bombula fikse zjarri, shit-blerje mjete e pajisje spitalore dhe sherbimi i tyre, blerje e shitje matesa uji, shitje - blerje kaldaja si dhe pjese kembimi per to. Shit - blerje tonera per kompjutera, etj. Shitje me shumice dhe pakice matesa uji dhe shitje me shumice dhe pakice kondicionere. Shit-blerje pajisje te te gjitha llojeve per zjarrfikese. Shitblerje pajisje te te gjitha llojeve te materialeve hidraulike. Shitblerje te te gjitha llojet e luleve, bimeve, pemeve frutore dhe pemeve, drureve te cdo lloji. Shit-blerje , materiale rroba per spitale, per institucione te te gjitha llojeve. Erresimi i xhamave te automjeteve. Dhenie e automjeteve me qera. Sherbim transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit. Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë të mjeteve me motor dhe rimorkio.**

**1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.**

## **Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise**

**2.1. Ortaku i vetem vendosi qe shoqerine te emertoje "KORRIKU 31" SHPK.**

**2.2. Selia kryesore juridike e Shoqerise ndodhet ne: Njesia Nr. 4, Rruga Aleksander Moisiu, Pallati 6/1, Shkalla 1, Kati 1, Apartamenti 2.**

**2.3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.**

## **Neni.3. Regjimi Juridik**

**3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.**

**3.2. Me vendim te tij Ortaku i vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.**

**3.3.** Shoqeria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe në përputhje me ligjin

**3.4.** Shoqeria do të ketë vlerën e saj

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4. Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut**

**4.1.** Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

**4.2.** Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

**4.3.** Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

**4.4.** Shoqëria përgjigjet ndaj të tregëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban përgjegjësi personale për detyrimet që merr për shërbime shoqëria.

**4.5.** Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj.

**4.6.** Ortaku përballon humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tij në kapitalin themeltar.

#### **Neni 5. Kohezgjatja**

**5.1.** Kohezgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar

## **Kreu III**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 6**

**6.1.** Kapitali themeltar është 100.000 (njëqind mijë) leke dhe është i ndarë në 1 kuotë.

**6.2.** Ndarja e pjesëve në kapitalin themeltar është : **Iredi Xhaferllari, 1 kuotë, përkatësisht 100% të kuotave.**



**6.3.** Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem

**6.4.** Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

#### **Neni 7- Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar**

**7.1.** Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakëve te shoqerise apo edhe kundrejt te treteve.

**7.2.** Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortakët, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakut te vetem.

**7.3** Ne rastit e shume ortakëve, ortakët ekzistues gezojne te drejten e parablerjes, te kuoteve ne shitje.

### **Kreu IV**

#### **DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE**

##### **Neni 8**

**8.1.** Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**8.2.** Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.

**8.3.** Organet kryesore te shoqerise jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga ortakut i vetem dhe Administratori.

##### **Neni 9**

#### **Asambleja e Pergjithshme e shoqerise**

Asambleja e pergjithshem perbehet nga ortakut i vetem i shoqerise qe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrime t e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortakut i vetem. Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori, Eksperti kontabel i autorizuar ose ortakut i vetem i shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakëve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortaku mund të perfaqesohet në asamble nëpërmjet një perfaqesuesi, duke qenë i autorizuar me prokurë të posaçme, dhe të marrin vendime vetëm për ato çështje që diskutohen në mbledhjen për të cilën ata kanë marrë të drejtën e perfaqesimit.

Mbledhjet e asamblese pasqyrohen në procesverbalin që mbahet me këto rast, ndërsa vendimet nënshkruhen nga ortaku i vetëm.

Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhenat e të cilin nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka të drejtë të marrë vendime për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar.
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronja "c" dhe "ç" të kësaj pike.
- dh) Mbiqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- h) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese.
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

## **Kreu V**

### **ADMINISTRIMI**

#### **Neni 10**

**10.1.** Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm, i cili mund të zgjidhet edhe jashtë ortakeve të shoqërisë.

**10.2.** Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetëm.

**10.3.** Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga **Administratori Iredi Xhaferllari**.



**10.4.**Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese)vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit.

**10.5.**Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

**10.6.**Administratorit i takon firma/nenshkrimi e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.

**10.7.**Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.

**10.8.**Kompetencat kryesore te administratorit ne shoqeri jane :

- kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortakut i vetem :
- perfaqeson shoqerine tregtare.
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim.
- krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- raporton perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.
- administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortakut i vetem.
- kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise.
- te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjithe veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.

- ti propozoje ortakut te vetem per miratim strukturen e aparatit te Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise .
- ti propozoje ortakut te vetem per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

## **Kreu VI**

### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 11**

**11.1.**Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**11.2.**Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaku i vetem.

**11.3.**Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### **Neni 12-Kontrolli i Shoqerise**

**12.1.**Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortakut i vetem.

**12.2.**Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise , kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon ghithe librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve.Mund te aktivizojte eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.

**12.3.**Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakut te vetem.



## **Kreu VII**

### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 13**

**13.1.** Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak, si ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaku.

**13.2.** Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, ortaku i vetem emeron nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit te Shoqerise , mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

**13.3.** Ne fund te procesit te likujdimit, ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

**13.4.** Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapilit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakun e vetem te shoqerise.

#### **Neni 14. Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

**14.1.** Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

## **Kreu VIII**

### **DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **Neni 15**

**15.1.** Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut , do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacionit koherent.

**15.2.** Ky statut hartohet ne 3 (tre) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Iredi Xhaferllari**